



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 249, datë 24.12.2019

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK TË DËMEVE TË
SIGURIMEVE TË DETYRUESHME MOTORIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 38 pika 1, germa d) dhe pika 2, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Për Regjistrin Elektronik të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rregullorja nr. 36, datë 30.04.2009 “Për Regjistrin Elektronik të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike”, e ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI